

Krijimi i qenieve të gjalla nga uji

v1.00

“All-llahu krijoi secilën gjallesë prej një uji, e prej tyre ka që ecin rrëshqanas në barkun e vet, ka që ecin në të dy këmbët e edhe asosh që ecin në të katër këmbët. All-llahu krijon çka të dojë, pse vërtet All-llahu ka mundësi për çdo gjë.” Kur’an 24:45

Uji është komponentë kryesore e materies organike. Midis 50-90% të peshës së qenieve të gjalla përbëhet nga uji. Për më tepër, 80% e citoplazmës (material bazë i qelizës) është ujë. Analiza e citoplazmës u zhvillua qindra vjet pas shpalljes së Kur’anit.

Malet si stabilizues të Tokës

Malet luajë një rol të rëndësishëm në stabilizimin e kores së tokës, duke penguar dridhjen e saj. Zoti ka thënë në Kur’an:

“Dhe Ai vuri kodra (të forta) në tokë, ashtu që ajo të mos lëkundet me ju...” Kur’an 16:15

Gjithashtu, teoria moderne e pllakave tektonike tregon që malet luajnë rolin e stabilizuesve për tokën. Njohuria lidhur me rolin e maleve si stabilizues sapo ka filluar të kuptohet nga shkencëtarët në kuadrin e pllakave tektonike.

Çfarë thonë shkencëtarët modernë?

Dr Keith L. Moore, Profesor i Anatomisë dhe Biologjisë Qelizore, ishte dekan bashkëpunëtor i shkencave themelore në Fakultetin e Mjekësisë si dhe Kryetari i Departamentit të Anatomisë. Ai është autor i librit me titull “Zhvillimi i njeriut”, i cili është përkthyer në tetë gjuhë dhe është zgjedhur nga një komitet i veçantë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës si libri më i mirë i shkruar nga një person.

Gjatë një konference, profesor Moore tha:

“Ishte një kënaqësi e madhe për mua të ndihmoj në sqarimin e deklaratave në Kur’an lidhur me zhvillimin njerëzor. Është e qartë për mua se këto deklaratat duhet t’i kenë ardhur Muhammedit nga Zoti, sepse pothuajse e gjithë kjo njohuri nuk është zbuluar deri

shumë shekuj më vonë. Kjo dëshmon për mua se Muhammedi duhet të ketë qenë i dërguari i Zotit.”

Dr. T. V. N. Persaud, Profesor i Anatomisë, Profesor i Pediatriisë dhe Shëndetësisë së fëmijëve, dhe Profesor në Klinikën e Obstetrikës, Gjineologjisë dhe Shkencave të riprodhimit në Universitetin e Manitoba, Kanadë, ishte Kryetar i Departamentit të Anatomisë për 16 vjet. Ai është autor dhe botues i 22 teksteve shkollore dhe ka publikuar mbi 181 dokumente shkencore. Ai mori çmimin më të shquar në fushën e anatomisë në Kanadë – J.C.B. Grant Award, nga Shoqata Kanadeze e Anatomisë.


Kur ai u pyet për mrekullitë shkencore në Kur’an të cilat i ka hulumtuar, ai deklaroi se:

“Në këtë rast kemi një njeri analfabet që bën prononcime të thella dhe deklarata që janë çuditërisht të sakta për natyrën shkencore. Dhe unë personalisht nuk mund të kuptoj se si kjo mund të jetë një rastësi e thjeshtë. Ka saktësi shumë të madhe, si Dr Moore, edhe unë nuk kam asnjë vështirësi të pranoj se ky është një frymëzim ose shpallje hyjnore që e bëri atë të bëjë këto deklarata.”

Në përfundim

Kjo broshurë është vetëm një paraqitje e shkurtër e shumë fakteve shkencore të përmendura në Kur’an. Për shkak të kufizimit në hapësirë, tema të tilla si ajo që thotë Kur’ani për ciklin e ujit, oqeanet, astronominë, historinë, anatominë e njeriut, florën dhe faunën, nuk mund të përfshihen. Këto fakte shkencore u zbuluan rreth 1400 vjet më parë, kur pajisjet teknologjike dhe njohuritë nuk ishin në nivel për të bërë zbulime të tilla. Kjo dëshmon se jo vetëm këto fakte, por e gjithë përmbajtja e Kur’anit është shpallje hyjnore nga Zoti Një, I Vërtetë që e krijoi Universin dhe gjithçka ka në të. Bëhu prej atyre që lexojnë dhe zbulojnë bukurinë dhe të vërtetën e Kur’anit, që të zbuloni bukurinë dhe të vërtetën e kësaj bote dhe të botës së përtejme!

Shkenca në Islam



Informacion

tel 045 633 370 web islamifejaevvertete.com @ broshurat@gmail.com

Emri i bankës Pro Credit Bank

Kontoja 1184001037000102 Swift MBKORS22

gjërat
themelore

islamifejaevvertete.com

Hyrje

Kur'ani është shpallje e fundit nga Perëndia për njerëzimin. Edhe pse Kur'ani, (i shpallur mbi katërmbëdhjetë shekuj më parë) nuk është kryesisht një libër i shkencës, përmban fakte shkencore që janë zbuluar shkencërisht vetëm kohët e fundit përmes përparimit të pajisjeve teknologjike. Për më tepër, kjo nuk ka nxitur një qëndrim anti-shkencor, por përkundrazi, inkurajon kërkimet shkencore. Në të vërtetë, studimi dhe të kuptuarit e natyrës së krijimit u mundëson njerëzve të vlerësojnë dhe të njohin Krijuesin e tyre dhe shkallën e Sovranitetit të Tij.

Zhvillimi i embrionit njerëzor

Në Kur'an, Zoti flet për fazat e zhvillimit embrional të njeriut: *“Ne e krijuam njeriun prej një ajke (lëngu), e një balte. Pastaj atë (ajkë - baltë) e bëmë (e shndërruam) pikë uji (farë) në një vend të sigurt. Më pas, atë pikë uji e bëmë copë gjaku, e atë gjak të ngurtë e bëmë copë mishi, e atë copë mishi e shndërruam në eshtra, edhe eshtrave ua veshëm mishin, pastaj atë e bëmë krijesë tjetër (me shpirt). I lartë është All-llahu, më i miri Krijues...”* Kur'an 23:12-14




Figure 1: Vizatimet ilustrojnë ngjashmëritë në mes të një shushunje dhe një embrioni njerëzor në fazën alakah.

Fjala arabe “alakah” ka tre kuptime: (1) shushunjë (gjallesë gjakpirëse) - kur e krahasojmë formën e një shushunje me një embrion në këtë fazë të caktuar (alaqah), shohim ngjashmëritë e padiskutueshme. Gjithashtu, embrioni në këtë fazë e merr ushqimin nga gjaku i nënës, në mënyrë të ngjashme me një shushunjë (shih figurën 1). (2) gjë pezulluar - kjo është ajo që mund të shihni në figurën 2. (3) mpiksje gjaku - dukjen e jashtme të embrionit dhe qeska e të verdhës së vezës gjatë fazës alaqah janë të ngjashme me atë të një mpiksje gjaku. Kjo është për shkak të sasive të mëdha të gjakut në embrion gjatë kësaj faze (shih figurën 3).




Figure 2: Ne mund të shohim në këtë diagram pezullimin e një embrioni gjatë fazës alakah në barkun e nënës (mitrën) e nënës. (Libri: “The Developing Human” - Moore dhe Persaud, edicioni i 5-të, fq. 66.)




Figura 3: Diagrami i sistemit primitiv kardiovaskular në një embrion gjatë fazës alakah. (Libri: “Zhvillimi i njeriut” - Moore dhe Persaud, edicioni i 5-të, fq. 65.)

Faza tjetër e përmendur është faza “mudghah” që do të thotë “substancë përtpur.” Nëse dikush do të përtpypë një çamçakëz dhe ta krahasojë atë me embrionin në këtë fazë, do të arrijmë në përfundimin se embrioni i ngjan shumë një substance të përtpur. Kjo është për shkak të somiteve (qelizat nga të cilat formohen vertebrat) në pjesën e prapme të embrionit që, sipas Dr Moore dhe Persaud, “Deri diku ngjajnë me shenjat e dhëmbëve që shihen në një substancë të përtpur.” Shih Figurën 4.




Figura 4:

A) Skica e një embrioni në fazën mudghah. Këtu mund të shihen somitet (qelizat nga të cilat formohen vertebrat) në pjesën e prapme të embrionit që duken si shenja dhëmbësh. (“The Developing Human”, Moore dhe Persaud, edicioni i 5-të, fq. 79.)
B) Fotografi e një cope çamçakëzi të përtpur.

40 ditë në barkun e nënës

Profesori Simpson është kryetar i Departamentit të Obstetrikës dhe Gjinekologjisë, dhe Profesor i Gjenetikës molekulare dhe të njeriut në Kolegjin Baylor të mjekësisë, Hjuston. Me studimin e dy thënieve të Profetit Muhamed (paqja qoftë mbi të):

“Vërtet çdo njëri nga ju formohet në barkun e nënës së tij për 40 ditë...”

dhe;

“Kur fara (në mitër) i mbush 42 netë, All-llahu e dërgon një engjëll që i jep formën....”

ai vuri në dukje se 40 ditët e para përbëjnë një fazë qartë të dallueshme të zanafillës së embrionit.

Sipas shkencës moderne, në fund të javës së gjashtë (42 netë), është koha kur zhvillimi embrional i gjymtyrëve është në kulmin e tij. Ky është kulmi i zhvillimit të shpejtë që ndodh në mes të javës së katërt dhe të tetë.

Ai ishte i impresionuar veçanërisht nga saktësia absolute dhe përpikëria e thënieve të Profetit Muhamed (paqja qoftë mbi të).

Dy detet që nuk përzihen njëri me tjetrin

Për sa i përket deteve, Zoti thotë: “I ka lëshuar dy dete që të takohen e në mes tyre ka stom (pengesë), andaj njëri nuk e mbizotëron tjetrin (nuk përzihen)” Kur'an, 55:19-20. Faktet shkencore se detet e cilësive të ndryshme nuk përzihen vetëm kohët e fundit janë zbuluar nga oqeanografët. Një forcë fizike e quajtur tensioni sipërfaqësor i pengon ujërat e deteve fqinj që të përzihen, për shkak të ndryshimit në dendësinë e këtyre ujërave. Është sikur një mur i hollë të jetë në mes tyre. (Shih Figurën 5).




Figura 5